



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 637 Akti

Nr. 588. Vendimi
Tiranë, më 22.11.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko	Kryesuese
Xhensila Pine	Relatore
Suela Zhegu	Anëtare

në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Jonida Vrana, në datën 21.11.2022 në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore lidhur me çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Markelian Koça**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONI TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, dëgjoi në seancën dëgjimore subjektin e rivlerësimit, z. Markelian Koça, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

i. Z. Markelian Koça është subjekt rivlerësimi bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë për shkak të funksionit të tij si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

ii. Bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, z. Markelian Koça i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Alma Faskaj dhe Xhensila Pine (relatore). Anëtarja Alma Faskaj është zëvendësuar me short për arsye objektive nga komisionerja Suela Zhegu.

iii. Komisioni administroi nga institucionet ndihmëse të procesit raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).

iv. Trupi gjykues, pas studimit të raporteve të vlerësimit të hartuara nga institucionet shtetërore, filloi hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Trupi gjykues caktoi kryesuese komisioneren Pamela Qirko dhe deklaroi mungesën e konfliktit të interesit.

v. Trupi gjykues, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit Markelian Koça, bazuar në tria kriteret e rivlerësimit; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave dhe thirrjen e dëshmitarëve, si dhe afatin e ushtrimit të tyre.

vi. Në datën 11.11.2022 subjektit iu dërguan rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit për sjelljen e provave dhe shpjegimeve për të provuar të kundërtën e barrës së provës. Subjekti paraqiti provat dhe shpjegimet brenda afatit të përcaktuar nga Komisioni.

I. SEANCA DËGJIMORE

vii. Në datën 21.11.2022, ora 12:30, u zhvillua seanca dëgjimore në prani të subjektit të rivlerësimit dhe vëzhguesit ndërkombëtar, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Seanca dëgjimore u ndërpre për të vijuar me shpalljen e vendimit të trupit gjykues në datën 22.11.2022, ora 13:45.

Në përfundim të seancës dëgjimore subjekti kërkoi konfirmimin në detyrë.

II. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

viii. Subjekti i rivlerësimit Markelian Koça ka qenë bashkëpunues gjatë procesit administrativ, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

III. PROCESI I RIVLERËSIMIT/ HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

A. VLERËSIMI I PASURISË

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera lidhur me këtë subjekt rivlerësimi, ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Pavarësisht se sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është autoriteti përgjegjës për kontrollin dhe vlerësimin e pasurisë për subjektet e rivlerësimit, referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni kreu një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi, duke hetuar në mënyrë të pavarur të gjitha faktet dhe informacionet e marra, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, nga ku rezultoi si vijon:

1. Apartament banimi me sip. 130 m², në Lagjen ***, Durrës

1.1. Në deklaratën *Vetting* subjekti e ka deklaruar këtë pasuri në bashkëpronësi me bashkëshorten, të përfituar sipas kontratës së shitjes me kusht nr. ***, datë 19.9.2016, të lidhur me shoqërinë “****” sh.p.k., në vlerë totale 75.000 euro. Nga subjekti është paguar vlera 14.000 euro, nga bashkëshortja 21.000 euro dhe pjesa 40.000 euro marrë me kredi të përbashkët në “Alpha Bank”, sipas kontratës së huas nr. ***, datë 20.10.2016, me kohëzgjatje 15 vjet.

1.2. Në DPV/2016 subjekti ka deklaruar apartament me sip. 130 m², në Lagjen ***, Durrës, në bashkëpronësi me bashkëshorten, sipas kontratës së shitjes me kusht nr. ***, datë 19.9.2016, e lidhur me shoqërinë “****” sh.p.k., në vlerën totale 75.000 euro. Burimi i krijimit: të ardhurat ndër vite nga pagat; angazhimet e tjera akademike dhe profesionale; si dhe pjesëmarrja si gjyqtar *ad hoc* në GJEDNJ, të deklaruar ndër vite. Shuma 75.000 euro, nga e cila është paguar nga subjekti shuma 14.000 euro, nga bashkëshortja 21.000 euro dhe pjesa prej 40.000 euro, marrë kredi të përbashkët në “Alpha Bank”.

1.3. Në bazë të kontratës së shitjes me kusht¹ nr. ***, datë 19.9.2016, subjekti dhe bashkëshortja E.V. kanë blerë nga shoqëria ndërtuese “****” sh.p.k. apartamentin me sip. 130 m², në Lagjen ***, Durrës, kundrejt çmimit 75.000 euro, shumë e cila likuidohet mes palëve përkatësisht: (i) kësti i parë në shumën 35.000 euro, likuidohet nëpërmjet “Alpha Bank” në ditën e nënshkrimit të kontratës, sipas mandateve përkatëse që shoqërojnë këtë kontratë; (ii) kësti i dytë në shumën 40.000 euro do të likuidohet nëpërmjet kredisë që do t’i akordohet blerësve nga “Alpha Bank”,

¹ Pjesë e dosjes *Vetting*.

kredi e cila do të kalojë në llogari të noteres dhe pas pajisjes së blerësve me certifikatë pronësie nga ana e zyrës së regjistrimit të pasurive Durrës, do t'i kalojë shoqërisë “****” sh.p.k.

1.4. Me transfertën datë 19.9.2016 të “Alpha Bank” subjekti i rivlerësimit ka transferuar në llogari të shoqërisë shumën 14.000 euro, ndërsa znj. E.V. ka transferuar nga llogaria e saj për llogari të shoqërisë “****” sh.p.k. shumën 21.000 euro².

1.5. ZVRPP-ja Durrës informon ILDKPKI-në se rezulton pasuria e regjistruar me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, e llojit “apartament” me sip. 130 m², në bashkëpronësi të shtetasve Markelian Koça dhe E.V., regjistruar në datën 16.11.2016.

Lidhur me kohën e pagesës së çmimit, burimin e deklaruar dhe mundësinë financiare

1.6. Referuar kontratës së shitjes me kusht të datës 19.9.2016, kësti i parë në shumën 35.000 euro likuidohet nëpërmjet “Alpha Bank” në ditën e nënshkrimit të kontratës, ndërsa kësti i dytë në shumën 40.000 euro do të likuidohet nëpërmjet kredisë që do t'i akordohet blerësve nga kjo bankë.

1.7. Referuar të dhënave nga “Alpha Bank”³ rezulton se në datën 31.12.2015 subjekti i rivlerësimit ka pasur gjendje në llogari Alpha Start shumën 17.002,52 euro, ndërsa znj. E.V. ka pasur gjendje në llogarinë në emër të saj shumën 21.003,22 euro.

1.8. Këto shuma e kanë burimin nga transferimi në llogari të shtetasve E.V. dhe Markelian Koça, përkatësisht, shumat 21.000 euro dhe 14.000 euro nga shoqëria “****” sh.p.k., nëpërmjet mandat urdhërpagesës në “Alpha Bank”, si zbatim i deklaratës noteriale nr. ***, datë 2.10.2015⁴, me të cilën është revokuar kontrata e sipërmarrjes nr. ***, datë 21.5.2014.

Kronologji e porositjes dhe revokimit të kontratës së sipërmarrjes për sip. 146 m²

1.9. Në DPV/2014 subjekti ka deklaruar shpenzime për lidhjen e kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 21.5.2014, me shoqërinë “****” sh.p.k., për ndërtim apartamenti për pagim të pjesshëm të vlerës së kontraktuar në masën 14.000 euro, e cila i është kaluar subjektit sipërmarrës nëpërmjet “Alpha Bank” në datat 21.5.2014 dhe 9.7.2014, me burim nga: (i) të ardhurat në “Alpha Bank” nga pjesëmarrja si gjyqtar *ad hoc* pranë EHCR; (ii) të ardhurat në “Credins Bank”, nga mësimdhënia pranë universitetit “****”; (iii) të ardhurat në “ProCredit Bank” nga mësimdhënia pranë universitetit ***; (iv) të ardhura në “Raiffeisen Bank” nga paga dhe cilësia si ekspert pranë Shkollës së Magjistraturës. Gjithashtu, personi i lidhur/bashkëjetuesja e subjektit (njëkohësisht edhe subjekt deklarimi sipas ligjit nr. 9049/2003 për shkak të pozicionit si gjyqtare) ka deklaruar shpenzime për lidhjen e kontratës nr. ***, datë 21.5.2014, me shoqërinë “****” sh.p.k. për ndërtim apartamenti në shumën 21.000 euro. Pagesë e kryer *cash* në llogari të shoqërisë së ndërtimit në “Alpha Bank” në datën 23.5.2014.

1.10. Referuar kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 21.5.2014, me shoqërinë “****” sh.p.k., porositësit Markelian Koça dhe E.V. kanë porositur apartamentin me sipërfaqe të përgjithshme

² Dokumentacion i dorëzuar nga subjekti me deklaratën *Vetting*.

³ Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 26.1.2021.

⁴ Dokumentacion pjesë e shkresës kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 3.3.2021, nga ILDKPKI-ja.

146 m², në Lagjen ***, Durrës, kundrejt shumës 77.000 euro, për të cilin u pagua shuma 5.000 euro, në datën 21.5.2014, kësti i dytë në vlerën 30.000 euro, përcaktuar të paguhej brenda 20 ditëve nga dita e nënshkrimit të kontratës, kësti i tretë në shumën 35.000 euro do të shlyhej nëpërmjet një kredie bankare dhe kësti i fundit do të paguhej me nënshkrimin e kontratës së shitblerjes.

1.11. Me deklaratën noteriale nr. ***, datë 2.10.2015, deklaruesit shoqëria “****” sh.p.k., Markelian Koça dhe E.V. kanë deklaruar anulimin e kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 21.5.2014, duke i kthyer shtetasve Markelian Koça dhe E.V. shumën 35.000 euro, nëpërmjet dy mandateve të “Alpha Bank”, dega Durrës.

1.12. Në DPV/2015, subjekti ka deklaruar shtim të të ardhurave nga revokimi i kontratës me nr. ***, datë 21.5.2014, me shoqërinë “****” sh.p.k., në shumën 14.000 euro. Personi i lidhur ka deklaruar gjithashtu shtim të ardhurash si pasojë e revokimit të kontratës së sipërmarrjes me shoqërinë ndërtuese “****” sh.p.k. në shumën 21.000 euro.

1.13. Veprimet juridike të kryera nga subjekti dhe personi i lidhur janë në përputhje me dispozitat e Kodit Civil (revokimi i kontratës me vullnetin e përbashkët të palëve dhe nënshkruar para noterit).

Analizë e burimit të të ardhurave për pagesën e shumës 35.000 euro në vitin 2014

1.14. Bazuar në të dhënat nga bankat e nivelit të dytë rezulton se në datën 31.12.2013 gjendja në llogaritë bankare të subjektit është në vlerën rreth 3.087.273 lekë. Subjekti ka transferuar nga llogaria e tij Alpha Start në euro, në datën 21.5.2014, shumën 5.500 euro me përshkrimin “për *** sh.p.k., likuiduar sipas kontratës së sipërmarrjes datë 21.5.2014” dhe në datën 9.7.2014 shumën 8.500 euro me përshkrimin “për *** sh.p.k. likuidim për blerje apartamenti sipas kontratës nr. ***, datë 21.5.2014.

1.15. Ndërsa znj. E.V. në DPV/2014, për pagimin e pjesshëm të vlerës së kontraktuar në masën 21.000 euro (konvertuar në 2.940.000 lekë), e cila i ka kaluar shoqërisë sipërmarrëse në datën 23.5.2014 pranë “Alpha Bank”, ka deklaruar se është tërhequr nga prishja e depozitës me vlerë 2.000.000 lekë mbi llogarinë e pagës në “Credins Bank”, si dhe diferenca prej 940.000 lekësh e tërhequr nga llogaria e pagës po pranë kësaj banke.

1.16. Bazuar në të dhënat e “Credins Bank”⁵, znj. E.V., në datën 5.10.2012, kalon në depozitë me afat 12-mujor shumën 1.000.500 lekë. Kjo shumë e ka burimin nga të ardhurat nga paga si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, filluar nga viti 2010. Gjendja e llogarisë së pagës në datën 31.12.2012 rezulton në shumën 979.872 lekë. Në datën 17.10.2013 është kthyer në llogari rrjedhëse të pagës në këtë bankë depozita në shumën 1.058.091 lekë dhe në të njëjtën ditë ka kaluar në depozitë 12-mujore shuma 2.000.000 lekë dhe në datën 23.5.2014 është tërhequr *cash* nga depozita shuma 2.000.000 lekë nga znj. E.V. Gjithashtu, në bazë të të dhënave nga “Credins Bank” rezulton se shtetasja E.V. ka tërhequr *cash* nga llogaria e pagës në lekë, në datën 23.5.2014, shumën 940.000 lekë.

⁵ Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 10.3.2021.

1.17. Sa më sipër, vërtetohet deklarimi i subjektit dhe personit të lidhur për kohën dhe mënyrën e shlyerjes së shumës 35.000 euro për shoqërinë “****” sh.p.k. në vitin 2014.

1.18. Nga Komisioni, në konsideratë të faktit që subjekti i rivlerësimit dhe znj. E.V. kanë deklaruar bashkëjetesë që nga janari i vitit 2011⁶, u vlerësua që të mos bëhej një analizë e veçantë për çdo burim të ardhurash të deklaruar nga secili prej tyre për shumat 14.000 euro dhe 21.000 euro (për periudhën pas vitit 2011), pasi në analizën e përgjithshme financiare janë përfshirë të ardhurat e sipërpërmendura, pasuritë (përfshirë likuiditetet) e krijuara, si dhe shpenzimet e deklaruara dhe llogaritura, si për subjektin e rivlerësimit ashtu edhe për personin e lidhur.

1.19. Sa më sipër, Komisioni, përveç analizës përmbledhëse, kreu një analizë paraprake të treguesve financiarë për periudhën 1.1.2014 – 9.7.2014, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit dhe personit të lidhur për kryerjen e pagesës së shumës 35.000 euro shoqërisë “****” sh.p.k., si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara/evidentuara dhe llogaritura për këtë periudhë.

1.20. Nga analiza financiare ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur burime financiare të mjaftueshme për pagesën e çmimit të porositjes së blerjes së apartamentit në Durrës, te shoqëria “****” sh.p.k. në shumën 35.000 euro deri në datën 9.7.2014, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara/evidentuara dhe llogaritura për periudhën 1.1.2014 – 9.7.2014.

Kredi e përbashkët në “Alpha Bank”

1.21. Me kontratën e huas datë 20.10.2016⁷, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë përfituar nga “Alpha Bank” huan në shumën 5.560.000 lekë, me qëllim për të financuar blerjen e apartamentit sipas kontratës së shitblerjes me kusht, datë 19.9.2016, lidhur midis shoqërisë “****” sh.p.k. (pala shitëse) dhe shtetasve Markelian Koça dhe E.V. (pala blerëse), me objekt shitblerjen e pasurisë së llojit “apartament” me sip. 130 m², ndodhur në rrugën “****”, Durrës. Kjo hua është dhënë me një afat 180 muaj dhe si barrë hipotekore është vendosur pasuria apartament me sip. 130 m², në pronësi të shoqërisë “****” sh.p.k.

1.22. Në dokumentacionin pjesë të dosjes *Vetting* nga subjekti është bashkëlidhur, ndër të tjera, edhe transferata e brendshme datë 24.10.2016, në “Alpha Bank”, nëpërmjet së cilës nga llogaria e përbashkët e z. Markelian Koça ose znj. E.V. është transferuar në llogari të noteres shuma 5.560.000 lekë, me përshkrimin “Markelian Koça, E.V. për A.S. PF, kontratë nr. *** rep., nr. ***kol., datë 19.9.2016”.

1.23. Nga administrimi dhe vlerësimi i dokumentacionit të siguruar nga hetimi nuk u konstatuan problematika lidhur me këto pasuri të paluajtshme, si dhe nuk u evidentuan *indicie* për hetime të mëtejshme në kuptim të kriterit pasuror për subjektin e rivlerësimit.

⁶ Në përgjigje të pyetësorit standard⁶ ka deklaruar se nga janari i vitit 2011, subjekti ka filluar bashkëjetesë me shtetasen E.V., me të cilën ka lidhur martesë në kishë në datën 1.10.2011. Në datën 29.9.2016, ka lidhur martesë ligjore me këtë shtetase.

⁷ Bashkëlidhur në dokumentacionin pjesë të dosjes *Vetting*.

2. Pasuri të luajtshme (pajisje elektroshtëpiake dhe mobilje) me vlerë 2.311.448 lekë

2.1. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar pasuri të luajtshme (pajisje elektroshtëpiake dhe mobilje) me vlerë 2.311.448⁸, nga të cilat paguar prej subjektit 1.561.000 lekë, burimet financiare për vlerat e paguara janë krijuar nga të ardhura nga paga ndër vite, angazhimet e tjera akademike dhe profesionale, si dhe pjesëmarrja si gjyqtar *ad hoc* në GJEDNJ të deklaruara. Bashkëshortja E.V., në deklaratën e pasurisë së personit të lidhur, pjesë e deklaratës *Vetting*, ka deklaruar pasuri të luajtshme (pajisje elektroshtëpiake dhe mobilje) me vlerë 750.448 lekë, burimet financiare për vlerat e paguara prej saj janë krijuar nga të ardhurat nga paga ndër vite, si dhe angazhimet e tjera akademike dhe profesionale.

2.2. Në DPV/2016, subjekti ka deklaruar pasuri të luajtshme (mobilje) në vlerën 1.561.000 lekë dhe si burim ka deklaruar të ardhurat e krijuara ndër vite nga paga, angazhimet e tjera akademike e profesionale, si dhe pjesëmarrja si gjyqtar *ad hoc* në GJEDNJ, të deklaruar ndër vite, ndërsa bashkëshortja në deklaratën e interesave private të personit të lidhur për këtë vit ka deklaruar pasuri të luajtshme me vlerë 750.448 lekë. Burimet financiare janë krijuar nga të ardhurat nga paga ndër vite, angazhimet e tjera akademike dhe profesionale, duke specifikuar se *asnjë prej tyre në veçanti nuk ka vlerën mbi 300.000 lekë dhe as janë të regjistrueshme në regjistrat publikë, por deklarohen për shkak të faturës tatimore përmbledhëse për disa njësi.*

2.3. Bazuar në dokumentacionin e depozituar nga subjekti dhe të administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ rezulton se shuma e faturuar prej 2.311.448 lekësh është likuiduar deri në datën 31.12.2016. Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë për vitin 2016, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit dhe personit të lidhur për pagesën e çmimit të blerjes së apartamentit me sip. 130 m² në Durrës, në shumën 75.000 euro, blerjen e pajisjeve elektroshtëpiake dhe mobiljeve në shumën 2.311.448 lekë, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara/evidentuara dhe llogaritura për periudhën 1.1.2016 – 31.12.2016.

2.4. Nga analiza financiare ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur (bashkëshortja e tij) kanë pasur burime financiare të mjaftueshme për pagesën e çmimit të blerjes së apartamentit në Durrës në shumën 75.000 euro, në vitin 2016, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara/evidentuara dhe llogaritura për periudhën 1.1.2016 – 31.12.2016.

2.5. Nga administrimi dhe vlerësimi i dokumentacionit të siguruar nga hetimi nuk u konstatuan problematika lidhur me këto pasuri të luajtshme, si dhe nuk u evidentuan *indicie* për hetime të mëtejshme, në kuptim të kriterit pasuror për subjektin e rivlerësimit.

⁸ (i) faturë tatimore nr. ***, datë 25.10.2016, me shitës shoqërinë “****” sh.p.k. dhe blerës E.V., në shumën 461.458 lekë; (ii) faturë tatimore nr. ***, datë 25.10.2016, me shitës H.F. dhe blerës E.V., në shumën 109.000 lekë; (iii) faturë tatimore nr. ***, datë 16.12.2016, me shitës “****” sh.p.k. dhe blerës E.V., në shumën 59.999 lekë; (iv) faturë tatimore nr. ***, datë 3.11.2016, me shitës P.K. dhe blerës M. K., në shumën 506.000 lekë; (v) faturë tatimore nr. ***, datë 14.11.2016, me shitës P.K. dhe blerës M. K., në shumën 100.000 lekë; (vi) faturë tatimore nr. ***, datë 23.12.2016, me shitës P.K. dhe blerës M. Koça, në shumën 550.000 lekë; (vii) faturë tatimore nr. ***, datë 28.12.2016, me shitës P.K. dhe blerës M. K., në shumën 50.000 lekë; (viii) faturë tatimore nr. ***, datë 28.12.2016, me shitës P.K. dhe blerës M. K., në shumën 475.000 lekë.

3. Automjet tip “**”**

3.1. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar këtë automjet, vit prodhimi 1999, blerë në datën 22.3.2008, me kontratë nr. ***, në vlerën 470.000 lekë, në pronësi të tij, me burim të ardhura nga paga, angazhimet akademike dhe profesionale të deklaruara prej tij.

Në DPV/2008, subjekti ka deklaruar automjet në vlerën 500.000 lekë, por nuk ka deklaruar burimin e të ardhurave.

3.2. DPSHTRR-ja⁹ informon ILDKPKI-në se subjekti Markelian Koça ka të regjistruar automjetin me targa ***, bazuar në kontratën e shitblerjes së automjetit nr. ***, datë 22.3.2008, me anë të së cilës subjekti ka blerë automjetin tip “****”, kundrejt çmimit 470.000 lekë.

3.3. Referuar deklaratës doganore ***, datë 10.1.2008¹⁰, ky automjet është deklaruar i blerë në shumën 2.300 euro dhe shpenzimet e zhdoganimit janë llogaritur në vlerën 222.059 lekë [në total (2.300 euro*121.78 lekë/euro + 222.059 lekë)] = 502.153 lekë.

Analiza e burimit të të ardhurave dhe mundësia financiare

3.4. Në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit, si burim për blerjen e kësaj pasurie, ka deklaruar të ardhurat nga paga ndër vite, si dhe angazhimet e tjera akademike dhe profesionale.

3.5. Në pyetësin standard¹¹, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *“Kur kam blerë makinën tip ‘****’ në muajin mars të vitit 2008, për përballimin e vlerës së saj janë përdorur edhe kursimet në vite të administruara nga nëna ime, me burim të ardhurat e mia që nga viti 2003, kontribut për familjen dhe që janë mbajtur prej saj”*.

3.6. Mbështetur në dokumentacionin e administruar dhe në deklaratimet e subjektit, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit për blerjen në datën 22.3.2008 të automjetit tip “****”, në vlerën 470.000 lekë, shtesën në likuiditet në llogaritë bankare, si dhe kryerjen e shpenzimeve të evidentuara për periudhën 1.1.2008 – 28.3.2008¹², nga ku rezultoi pamundësia financiare në shumën 291.276 lekë.

3.7. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 subjektit i kaloi barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova, për sa duket se: (i) ka mospërputhje të deklaratimit në deklaratën *Vetting* me deklaratimin periodik mbi çmimin e blerjes; (ii) nuk ka arritur të dokumentojë burimin e deklaruar të të ardhurave për pagesën e çmimit të blerjes së automjetit tip “****”, duke rezultuar me pamundësi financiare në shumën -291.276 lekë, në datën 28.3.2008.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

3.8. Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës se provës, ndër të tjera, deklaroi se: *“Sa i takon mospërputhjes në vlerë të konstatuar nga Komisioni, sqaroj se vlera e automjetit është ajo e*

⁹ Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 2.8.2017.

¹⁰ Depozituar edhe nga subjekti në dokumentacionin pjesë të dosjes *Vetting*.

¹¹ Përgjigje të pyetjes nr. 4.

¹² Në referencë të përcaktimeve të kontratës së shitjes, në të cilën shuma 470.000 lekë do të dorëzohej në kohën e regjistrimit të automjetit.

shënuar në kontratën e shitblerjes (470.000 lekë). Vlera e deklaruar në DPV-në vjetore në shumën 500.000 lekë, është një gabim material, i cili ka ardhur për shkak se plotësimi i DPV/2008 është kryer pa pasur përpara dokumentin fizik (kontratën e shitblerjes së automjetit).

Në lidhje me konstatimin për pamundësi financiare në shumën 291.276 lekë, në datën 28.3.2008, siç kam deklaruar gjatë hetimit administrativ, deri në vitin 2010 kam jetuar në një ekonomi të përbashkët familjare me prindërit e mi dhe të ardhurat në familje administroheshin nga nëna ime. Bazuar edhe në jurisprudencën Komisionit¹³ kërkoj të merrni në konsideratë të ardhurat e krijuara prej meje përpara vitit 2008, por të administruara nga nëna ime si kursime familjare në kushtet e një ekonomie të përbashkët, për të konkluduar se kam pasur mjaftueshmëri burimesh financiare për blerjen e automjetit në shumën 470.000 lekë në vitin 2008”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

3.9. Trupi gjykues i Komisionit, pasi administroi provat, dëgjoji shpjegimet e subjektit pas kalimit të barrës së provës, duke iu referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit në deklaratën *Vetting* dhe atyre periodike, si dhe deklaratimet e subjektit mbi faktet e dala gjatë hetimit administrativ.

3.10. Saktësia dhe mjaftueshmëria e deklarimeve për një subjekt deklarimi vlerësohet vetëm përmes deklarimeve të sakta dhe të plota. Trupi gjykues çmon se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për mënyrën e deklarimeve të kursimeve është i pambështetur në prova dhe në ligj.

3.11. Saktësia dhe mjaftueshmëria e deklarimeve për një subjekt deklarimi matet vetëm përmes deklarimeve të sakta dhe të plota. Detyrimi ligjor i subjektit të rivlerësimit për të deklaruar pasuritë ka lindur që nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar, përcaktimet e të cilit kanë qenë të qarta në këtë drejtim, lidhur me deklarimin e çdo pasurie, përfshirë edhe likuiditetet *cash*, si dhe shtesat dhe ndryshimet në to.

3.12. Për rrjedhojë, nga trupi gjykues kursimet në formën e likuiditetit *cash* jashtë sistemit bankar, shtesat dhe pakësimet, u llogaritën sipas deklarimeve të subjektit dhe personave të lidhur me të në deklaratat periodike/vjetore. Marrja në konsideratë e likuiditetit të pretenduar nga subjekti është një argument që nuk mbështetet në ligjin nr. 9043/2003, të ndryshuar, i cili ka parashikuar në mënyrë të qartë detyrimin e çdo subjekti për të deklaruar çdo shtesë e pakësim të pasurisë në çdo formë që ajo ndodh përgjatë një viti periodik.

3.13. Nga sa më sipërarsyetuar, analiza financiare përfundimtare e kryer për subjektin e rivlerësimit rezultoi në pamjaftueshmëri financiare për blerjen e automjetit dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera për vitin 2008 në shumën -291.276 lekë.

3.14. Trupi gjykues vlerëson se mungesa e likuiditetit për vitin financiar 2008, në shumën -291.276 lekë, nuk është në masën që cenon besimin e publikut.

¹³ Vendim nr. ***, vendim i formës së prerë¹³.

4. Apartament në rrugën “**”, Durrës**

4.1. Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se në deklaratën noteriale nr. ***, datë 17.7. 2020, “Për heqje dorë nga trashëgimia” subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *“Jam një nga trashëgimtarët ligjorë të të ndjerit babait të tim z. S.K., i cili ka nënshkruar kontratën për prenotim apartamenti me shoqërinë ‘****’ sh.p.k., datë 6.12.1999, apartament i përbërë nga dy dhoma e një kuzhinë, ndodhur në Lagjen ***, rruga ‘****’, aktualisht i paregjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, por që është në proces legalizimi, duke deklaruar se: ‘Heq dorë pa asnjë lloj pretendimi nga bashkëpronësia, pjesa ime e pronësisë së apartamentit të përshkruar më lart, duke ia lënë pjesën time nënës sime, njëres prej trashëgimtarëve, shtetases Gj.K., duke pasur të gjitha të drejtat ligjore për kryerjen e procedurës së legalizimit dhe pajisjen me certifikatë pronësie nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Dega Vendore Durrës në emër të saj”.*

Në pyetësorin nr. 1 subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar se: *“Nga muaji dhjetor i vitit 2000 deri në dhjetor të vitit 2010, kam jetuar në shtëpinë e blerë nga babai im, ndodhur në Lagjen ***, rruga. ‘****’, p. ‘****’, Durrës, përfutur nga kontrata e sipërmarrjes (ende e paregjistruar pranë ish-ZVRPP-së Durrës, sot Drejtoria Vendore Durrës e ASHK-së). Në këtë banesë unë kam jetuar më prindërit e mi (vëllai larguar në Itali që në datën 5.3.1991, ku jeton në mënyrë të pandërprerë edhe sot) dhe nuk ka pasur marrëdhënie qiraje. Aktualisht, në këtë banesë jeton nëna ime Gj.K., ndërsa babai ka ndërruar jetë në datën 1.6.2014”.*

4.2. Komisioni hetoi në lidhje me këtë pasuri pranë zyrave të ASHK-së dhe me shkresën nr. *** prot., datë 3.10.2022, ASHK Drejtoria Vendore Durrës informoi Komisionin se nga verifikimi në sistemin ALBSCAD multifunksional rezultoi se në arkivin fizik të ish-ALUIZNI-t Durrës, në emër të shtetases Gj.K. rezultoi formulari i vetëdeklarimit.

4.3. Me vërtetimin “Për lëshim vërtetimesh (negativ/pozitiv për të gjithë territorin datë 5. 10.2022¹⁴)”, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e ASHK-së, vërtetohet se znj. Gj.K. nuk e ka regjistruar këtë pasuri në regjistrin elektronik.

4.4. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 subjektit iu kërkua të japë shpjegime dhe prova për të provuar burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie të paluajtshme.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

4.5. Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me burimin për blerjen e këtij apartamenti, sqaroi se: *“Ky apartament është porositur në vlerën 25.494 USD, vlerë e cila provohet nga kryerja e tri pagesave të kryera për blerjen e këtij apartamenti¹⁵.*

¹⁴ Kthim përgjigjeje kërkesës me nr. ***, datë 4.10.2022.

¹⁵ Mandatarkëtimi nr. ***, datë 6.12.1999, në ditën e prenotimit të apartamentit babai im i ndjerë S.K. ka paguar shumën 1.210.000 S. Mandat i datës 4.1.2001, është kryer pagesa në llogarinë bankare të shoqërisë “****” sh.p.k., pranë Bankës së Kursimeve në shumën 10.000 euro. Gjithashtu, nëna ime ka të ruajtur dhe një mandatpagesë të datës 4.1.2001, të Bankës së Kursimeve, nga i cili rezulton se në të njëjtën ditë që është kryer pagesa te shoqëria “****” sh.p.k. nga llogaria e nënës sime pranë Bankës së Kursimeve është tërhequr shuma 10.000 USD. Mandat datë 22.11.2001, është kryer pagesa e fundit në llogarinë bankare të shoqërisë “****” sh.p.k., pranë Bankës së Kursimeve në shumën 5.489 USD. Gjithashtu, nëna ime ka të ruajtur dhe një mandatpagesë të datës 22.11.2001, po të Bankës së Kursimeve, nga i cili rezulton se në të njëjtën ditë që është kryer pagesa te

Sqarimi për pagesat e sipërcituara në vlerë dhe kohë sinkronizohet plotësisht me informacionin e marrë nga 'Raiffeisen Bank' sh.a. (e cila ka trashëguar ish-Bankën e Kursimeve)¹⁶. Burime të krijimit për blerjen e këtij apartamenti janë kontributi dhe kursimet e krijuara të familjarëve të mi, përfshirë edhe ato nga të ardhurat nga puna ime, si më poshtë vijon:

- të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit të vjetër në vlerën 1.450.000 lekë;
- të ardhura të vëllait E.K., krijuar nga viti 1991 në Itali deri në vitin 2005, të provuara nëpërmjet sa subjekti ka paraqitur të gjitha pagesat mujore për vitet 1996 – 2000 dhe deklaratimet vjetore (CUD) të të ardhurave, të shtetasit E.K. për vitet 1996 – 2001;
- kursimet e realizuara nga të ardhurat nga paga e subjektit dhe nga paga e nënës;
- të ardhurat nga pensioni i babait S.K. ”.

4.5.1 Subjekti, gjithashtu, ka pretenduar se burimi i të ardhurave në familje kanë qenë edhe të ardhurat e realizuara nga babai i tij si tregtar ambulant i mallrave industrialë për vitet 1991 – 2007.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

4.6. Trupi gjykues i Komisionit, pasi administroi provat e mbledhura gjatë hetimit, provat e depozituara nga subjekti pas kalimit të barrës së provës dhe dëgjoji subjektin në seancë dëgjimore, vlerëson se të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit të mëparshëm në vlerën 1.450.000 lekë, të ardhurat nga paga e subjektit dhe nga paga e nënës, të ardhurat nga pensioni i babait si dhe të ardhurat e vëllait të subjektit E.K., krijuar nga viti 1991 në Itali deri në vitin 2005, të cilat plotësojnë kushtet në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, janë të mjaftueshme për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie në vlerën 25.494 USD, në vitin 1999.

4.7. Komisioni, lidhur me të ardhurat e babait të subjektit nga aktiviteti si tregtar ambulant i mallrave industrialë në vitet 1991 – 2007, vlerëson se ato nuk u arritën të provoheshin si të ardhura të ligjshme, në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, por mosmarrja në konsideratë e tyre si burim krijimi nuk ndikonte në aftësinë paguese të familjes së subjektit për krijimin e kësaj pasurie në vlerën 25.494 USD, në vitin 1999.

Lidhur me deklarin e bashkëshortes E.V.

5. Automjet tip “**”, vit prodhimi 2004**

5.1. Në deklaratën *Vetting* bashkëshortja e subjektit ka deklaruar këtë automjet të blerë në datën 9.11.2009, me kontratë shitblerjeje nr. ***, me vlerë 300.000 lekë, në pronësi të saj, me burim të ardhura nga paga dhe angazhime akademike dhe profesionale.

5.2. Në DPV/2009, znj. E.V. (në cilësinë e subjektit deklarues), në ndryshim të interesave private, ka deklaruar automjetin tip “****”, blerë me kontratë datë 9.11.2009, në shumën 300.000 lekë.

shoqëria “****” sh.p.k., nga llogaria e nënës sime pranë Bankës së Kursimeve (me nr. 5677) është tërhequr shuma 5.494 USD (shumë e cila më pas është kredituar në llogarinë e shoqërisë 5.489 + 5 USD).

¹⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 15.11.2022.

5.3. DPSHTRR-ja¹⁷ informon Komisionin se shtetasja E.V. ka të regjistruar automjetin me targa ***. Znj. E.V., me anë të kontratës së shitblerjes së automjetit nr. ***, datë 9.11.2009, ka blerë nga shtetasja K.Gj. automjetin tip “****” në shumën 300.000 lekë.

Analizë e burimit të të ardhurave dhe mundësia financiare

5.4. Në deklaratën *Vetting* personi i lidhur/bashkëshortja e subjektit, për blerjen e kësaj pasurie (të krijuar para bashkëjetesës/martesës me subjektin e rivlerësimit), ka deklaruar si burim *të ardhura nga paga dhe angazhime akademike dhe profesionale*.

5.5. Në deklaram të interesave periodike vjetore për periudhën deri në vitin 2008, znj. E.V. ka deklaruar të ardhura nga paga dhe angazhime të tjera akademike dhe profesionale.

5.6. Në bazë të këtyre deklarimeve personi i lidhur nuk ka të deklaruar gjendje kursimesh *cash* në banesë në datën 31.12.2008, ndërsa referuar gjendjeve në llogaritë bankare në këtë datë, rezultojnë të depozituara: (i) në llogarinë e pagës në “Raiffeisen Bank” shuma 406.488 lekë; dhe (ii) në llogarinë rrjedhëse në emër të saj në “Intesa Sanpaolo Bank” shuma 25.770 lekë.

5.7. Mbështetur në dokumentacionin e administruar dhe në deklaratimet e subjektit, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë për të evidentuar mundësinë financiare të personit të lidhur për blerjen e automjetit tip “****”, për shumën 300.000 lekë, shtesën në likuiditet në llogaritë bankare, si dhe kryerjen e shpenzimeve të evidentuara për periudhën 1.1.2009 – 26.11.2009¹⁸ dhe u konkludua se personi i lidhur ka pasur burime financiare të mjaftueshme për pagesën e çmimit të blerjes së këtij automjetit në bazë të kontratës së shitblerjes së datës 9.11.2009, në shumën 300.000 lekë, shtresën në llogarinë bankare në “Raiffeisen Bank”, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara/evidentuara dhe të llogaritura për periudhën 1.1.2009 – 26.11.2009.

5.8. Nga administrimi dhe vlerësimi i dokumentacionit të siguruar nga hetimi nuk u konstatuan problematika lidhur me këto pasuri të luajtshme, si dhe nuk u evidentuan *indicie* për hetime të mëtejshme, në kuptim të kriterit pasuror për subjektin e rivlerësimit.

6. Gjendja në llogarinë në “Alpha Bank”, në vlerat 21.565 lekë dhe 1.729 euro

6.1. Në DPV/2016 bashkëshortja e subjektit, në cilësinë e personit të lidhur, ka deklaruar llogaritë personale nga paga dhe shpërblimet në “Alpha Bank”, konkretisht: (i) llogari e mbetur në lekë, në datën 31.12.2016, në shumën 88.354.46 lekë; (ii) llogari e mbetur në euro, në datën 31.12.2016, në shumën 1.730.14 euro.

6.2. Bazuar në të dhënat nga “Alpha Bank”¹⁹ konfirmohet se llogaria në euro dhe gjendja e saj në datën e dorëzimit të deklaratës *Vetting*, është në vlerën 1.729 euro. Në këtë llogari në euro, në emër të personit të lidhur në këtë bankë është transferuar nga OSCE-ja në datën 10.8.2016, shuma 1.500

¹⁷ Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 26.1.2021.

¹⁸ Në referencë të përcaktimeve të kontratës së shitjes, në të cilën shuma prej 300.000 lekësh do të dorëzohej në kohën e regjistrimit të automjetit.

¹⁹ Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 26.1.2021.

euro dhe në datën 7.12.2016, shuma 250 euro, shuma të cilat janë deklaruar edhe në deklaratën individuale vjetore të të ardhurave për vitin 2016 nga znj. E.V.

6.3. Komisioni nuk konstatoi problematika në lidhje me krijimin dhe në deklarimin e gjendjes në llogarinë personale të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit.

Lidhur me kredinë e marrë nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në vitin 2004

6.4. Me shkresën nr. *** prot., datë 12.8.2022, Banka Amerikane e Investimeve informon Komisionin se shtetasja E.V. (bashkëshortja e subjektit) ka pasur pranë kësaj banke: llogari rrjedhëse në lekë, hapur në datën 10.12.2004 dhe mbyllur në datën 4.2.2013; dhe llogari kredie në euro, hapur në datën 9.12.2004, pasi ka marrë kredi hipotekore në shumën 10.000 euro, me afat maturimi 7-vjeçar.

6.5. Komisioni hetoi mbi kontratën e kredisë nr. ***, datë 9.12.2004, lidhur midis Bankës Kombëtare të Greqisë, në cilësinë e kredidhënësit dhe znj. E.V., në cilësinë e kredimarrësit, ku shuma e kredisë së dhënë është 10.000 euro, me afat të kredisë 7-vjeçar dhe qëllimi i dhënies së kredisë është blerja e një apartamenti.

6.6. Dorëzanës për këtë kredi janë shtetasit S. dhe F. V. (V.), të cilët kanë garantuar shlyerjen e kredisë me pasurinë nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, Lagjja ***, rruga “****”, apartamenti nr. ***, Durrës, në bashkëpronësi të tyre.

6.7. Objekti i kreditimit të kësaj pasurie me nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, lloji i pasurisë “apartament” ka qenë në pronësi të shoqërisë “****” sh.p.k. Me kontratë shitjeje nr. ***, datë 9.8.2009, ka kaluar në bashkëpronësi të shtetasve F. dhe S. V. Me kontratë dhurimi nr. ***, datë 18.1.2018, ka kaluar në pronësi të shtetasit S.V.

6.8. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, në lidhje me këtë kredi të shtetasës E.V., sa i përket qëllimit dhe destinacionit të saj, subjekti, ndër të tjera, sqaron se: *“Kredia në fjalë ka të bëjë me bashkëshorten time dhe është marrë në një kohë (viti 2004) kur unë nuk kam pasur asnjë lidhje të afërt me të. Në pasojë, trajtimi i pyetjes është bërë nga sa më ka deklaruar bashkëshortja dhe sa i kanë deklaruar kësaj të fundit prindërit e saj. Sipas bashkëshortes E.V., destinacioni i shumës së kredisë së marrë në vlerën 10.000 euro është marrë si ndihmesë për prindërit e saj, të cilët kishin lidhur marrëveshje për të blerë apartament nga subjekti ‘****’ sh.p.k. Kredia rezulton e lidhur midis Bankës Kombëtare të Greqisë si kredidhënëse dhe subjekteve E.V. si kreditore dhe prindërve të saj S. dhe F. V. si dorëzanës për garantimin e kredisë”*.

6.9. Subjekti ka deklaruar se as bashkëshortja dhe as ai nuk kanë tërhequr ndonjë të drejtë që vjen nga kjo pasuri.

6.10. Komisioni nuk konstatoi problematika në lidhje me këtë marrëdhënie kreditimi të bashkëshortes së subjektit, para bashkëjetesës së saj me subjektin e rivlerësimit.

Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

Në përfundim të procesit të rivlerësimit të pasurisë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij dhe ka dorëzuar në kohë

deklaratën e pasurisë. Ai nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij.

Trupi gjykues vlerëson se diferenca e konstatuar në analizën financiare të vitit 2008 nuk është në masën që cenon besimin e publikut dhe mungesa e këtij likuiditeti në këtë masë nuk përbën arsye për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka justifikuar bindshëm pasuritë e tij, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, duke arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

B. KONTROLLI I FIGURËS

7. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), si institucion kompetent për kontrollin e figurës, verifikimit të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, si dhe në përputhje me kërkesat e nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka paraqitur pranë Komisionit raportin fillestar nr. *** prot., datë 2.11.2017, për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, me konstatimin *për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës*.

7.1. Me shkresën nr. *** prot., datë 26.10.2022²⁰, DSIK-ja ka përcjellë raportin e përditësuar për kontrollin e figurës, bazuar në shkresën nr. *** prot., datë 21.7.2022, të Komisionit, i cili informon se: *Në konfirmim të konstatimit fillestar për përshtatshmëri në vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit Markelian S. Koça, gjykojmë që për rastin në fjalë konkluzioni të mbetet në vlerësimin tuaj nën dritën e informacioneve të tjera që mund të dispononi si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ që po kryhen ndaj subjektit”.*

7.2. Komisioni kërkoi dosjen e çështjes gjyqësore me palë paditëse shtetasin A. S., nga e cila rezultoi se me vendimin nr. ***, datë 4.4.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, në çështjen gjyqësore me palë paditëse A. S., të paditur B. K. dhe M. Gj., persona të tretë Bashkia Durrës, ZVRPP-ja Durrës, ka vendosur: “Pushimin e gjyqimit të çështjes civile që i përket paditësit A.S, për shkak të mosparaqitjes në gjykim të palës paditëse pa shkaqe të arsyeshme”.

7.3. Sa më sipër, Komisioni arriti në konkluzionin se të dhënat, të cilat sinjalizonin përfshirjen e subjektit në shpërdorim detyre, nuk provoheshin për sa nuk provohej favorizimi i palës në gjykim.

Konkluzioni i Komisionit për kontrollin e figurës

Në përfundim të procesit të rivlerësimit të figurës, bazuar në nenin DH të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaratimit për kontrollin e figurës, dhe nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

²⁰ Deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 28.10.2022, të KDZH-së.

Komisioni, lidhur me kriterin e figurës, nuk konstatoi *indicie* apo informacione, sipas kërkesave të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, që mund të përbënin dyshim të arsyeshëm gjatë kryerjes së hetimit administrativ ndaj subjektit të rivlerësimit.

Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. VLERËSIMI AFTËSIVE PROFESIONALE

8. Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit është kryer në bazë të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, në bazë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kreu VI, nenet 40 e vijues të tij, si dhe mbi bazën e kriterëve përcaktuar në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga organi kompetent, Këshilli i Lartë Gjyqësor.

ANALIZA E GJETJEVE

8.1. Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti; (ii) pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe (iii) të dhënave nga burimet arkivore në KLGJ.

Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

8.2. Subjekti i rivlerësimit Markelian Koça ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Ai njuh parimet e përgjithshme të së drejtës e të procesit të rregullt ligjor. Në disa raste ka përdorur referenca nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë.

8.3. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se identifikon normën materiale të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Ai ka njohuri të procedurave të gjyqimit në raport me llojin e çështjeve gjyqësore civile që ka shqyrtuar. Njuh aspektet e procesit të rregullt ligjor në drejtim të pjesëmarrjes së palëve në gjykim, të kontradiktoritetit e deri tek arsyetimi i vendimit gjyqësor. Nga ana tjetër, ndër tri dokumentet e përzgjedhura dhe pesë dosjet e vëzhguara janë ankimuar 7 prej tyre. Në të shtatë rastet, Gjykata e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit.

b) Arsyetimi ligjor

8.4. Subjekti i rivlerësimit ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore të hartuara prej tij, në përgjithësi janë të qarta dhe të kuptueshme. Në përgjithësi respekton rregullat e drejtshkrimit. Vendimet përfundimtare të tij plotësojnë kërkesat e legjislacionit procedural civil. Arsyetimi i vendimit është gjithëpërfshirës në raport me pretendimet e ngritura nga palët. Në tekstin e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve. Në nxjerrjen e konkluzioneve ai i kushton rëndësi analizës së normës ligjore. Arsyetimi i vendimit fokusohet te thelbi i çështjes. Në dispozitivin e vendimit, në të gjitha rastet e vëzhguara, është konstatuar se disponohet për shpenzimet procedurale/gjyqësore, si dhe tregohet e drejta e ankimit për palët.

Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

8.5. Subjekti i rivlerësimit, në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, në Dhomën Civile. Ai ka deklaruar se gjatë tre viteve të fundit i janë caktuar gjithsej 1010 çështje, ka përfunduar gjithsej 981 çështje për tre vjet, si dhe ka mbartur në vitin 2017 gjithsej 106 çështje të vitit 2016. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna është 97,1 %.

8.6. Sipas të dhënave statistikore konstatohet se ngarkesa sasiore e gjyqtarit me 532 çështje të tilla për tre vjet, ka qenë mbi standardin minimal. Vetëm një prej pesë dosjeve është dorëzuar në kryesekretari 2 ditë jashtë afatit ligjor 10-ditor. Konstatohet se subjekti ka aftësi për të përballuar ngarkesën në punë.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

8.7. Subjekti i rivlerësimit ka aftësi për përgatitjen e çështjeve për gjykim, në funksion të zgjidhjes së çështjeve. Gjatë gjykimit, ai identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe nxjerr urdhra e vendime të ndërmjetme për realizimin e tyre. Zhvillon sipas ligjit procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, që nga çelja e seancës, tek pretendimet fillestare të palëve, administrimin e provave, diskutimet përfundimtare të palëve e deri te shpallja e vendimit.

c) Aftësia për të administruar dosjet

8.8. Në çdo dosje civile të vëzhguar gjendet i administruar vendimi për caktimin e seancës përgatitore. Gjithashtu gjenden aktet e njoftimit të palëve, kërkesat me shkrim të tyre dhe provat e paraqitura. Procesverbalet e seancës përgatitore dhe ato gjyqësore të administruara në dosje, në përgjithësi rezultojnë se janë të plota, konform kërkesave të nenit 118 të Kodit të Procedurës Civile. Konstatohet se të gjitha seancat gjyqësore të vëzhguara kanë rezultuar të dokumentuara me regjistrim audio, tregues ky në respektim të funksionit të transparencës dhe solemnitetit në gjykim.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

8.9. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave lidhur me etikën në punë të gjyqtarit Markelian Koça rezulton se përgjatë periudhës së rivlerësimit ndaj tij nuk janë paraqitur ankesa për shkelje etike.

b) Integriteti

8.10. Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

8.11. Nga tri dokumentet e paraqitura prej tij dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Asnjë prej dokumenteve ligjore dhe

dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave, si dhe nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

8.12. Në të gjitha rastet e vëzhguara nuk është konstatuar që ndonjë prej palëve të ketë paraqitur kërkesa për përjashtim të gjyqtarit dhe as kërkesa të vetë gjyqtarit për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

8.13. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

8.14. Subjekti i rivlerësimit, në periudhën e rivlerësimit, ka marrë pjesë në 11 trajnime në Shkollën e Magjistraturës, gjithsej 19 ditë të formimit vazhdues. Lënda e trajnimeve ku ai ka marrë pjesë ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit të shkallës së parë, në përbërje të dhomës civile.

Konkluzioni për vlerësimin e aftësive profesionale

Trupi gjykues, bazuar në: (i) konstatimet e mësipërme; dhe (ii) në gjetjet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, bazuar në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konkludon se në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

DENONCIMET

9. Pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë depozituar 13 denoncime, i cili, pasi kreu një analizë të tyre, për dy denoncime vendosi t'i kalojë barrën e provës subjektit dhe, konkretisht në lidhje me: (i) denoncimin e shtetasit F.Gj.; dhe (ii) denoncimin e shtetasve E. dhe A. Sh.

9.1. Denoncim i shtetasit F. Gj., regjistruar me nr. *** prot., datë 19.6.2020, dhe vijuar me nr. *** prot. dhe nr. *** prot., ndaj subjektit për shkelje të etikës dhe korrupsion, favorizim të ish-sekretarit të tij. Bashkëlidhur formularit të denoncimit nuk ka asnjë dokumentacion. Komisioni kërkoi informacion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës në lidhje me çështjen civile me palë paditëse G.Gj., të paditur Ministria e Financave dhe Ekonomisë Tiranë, persona të tretë F. Gj., P.A., D.Gj. dhe Avokatura e Shtetit; objekti “detyrimi i të paditurit, Ministria e Zhvillimit të Ekonomisë, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes, të njohë pronar në trashëgimtarët e z. I.Gj. për pasurinë truall me sip. 400 m² pjesë e pasurisë nr. ***, z. k. ***, Lagjja ***, Durrës”.

Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. ***, datë 11.11.2019, ka vendosur: “Pranimin e kërkesëpadisë njohjen pronar të trashëgimlënësve I.Gj. për pasurinë e llojit ‘truall’ me sip. 400 m²”.

Me vendimin nr. ***, datë 20.4.2022, Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 11.11.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjekti iu kalua barra e provës të shpjegojë marrëdhënien me shtetasin G.Gj..

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, ndër të tjera, deklaroi se: *“Kjo çështje më është caktuar për gjykim me shortin e datës 28.12.2018, fakt që provohet me kopjen e vendimit nr. ***, datë 11.11.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Referuar rasteve të detyrueshme për heqjen dorë nga gjykimi sipas nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile⁶ nuk kam vlerësuar se kam pasur detyrim për të hequr dorë nga gjykimi i çështjes, pasi nuk kam qenë para asnjë rrethane të përcaktuar nga ligji procedural. Me shtetasin G.Gj. nuk kam asnjë njohje shoqërore, asnjë lidhje detyrimi apo ndonjë rrethanë tjetër që do të cenonte paanësinë dhe objektivitetin tim në gjykim. Gjithashtu, nuk më është paraqitur asnjë kërkesë nga palët për përjashtimin tim nga gjykimi i çështjes, përgjatë gjithë gjykimit të çështjes. Nuk kam pasur asnjëherë në varësi në marrëdhënie pune këtë shtetas dhe ky fakt provohet me shkresën nr. ***, datë 16.11.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe aktet bashkëlidhur, nga ku rezulton se nuk kam ushtruar detyrën e titullarit të institucionit në kohën kur shtetasi G.Gj. ka filluar punë, gjatë kohës që ka punuar dhe në momentin e largimit të tij dhe, për pasojë, nuk kam nënshkruar asnjë akt emërimi, nuk kam lidhur asnjë kontratë pune dhe as kam nxjerrë urdhrin nr. *** prot., datë 6.12.2018, ‘Për zgjidhjen e kontratës së punës dhe rregullimin e efekteve financiare’ me këtë shtetas.*

Denoncuesi është një person që është bashkëpronar me shtetasin G.Gj. dhe tërheq të njëjtat të drejta nga vendimi gjyqësor i disponuar prej meje (pasi njihet pronar kundrejt shtetit gjyshi i kërkuarit dhe babai i personit të tretë denoncues pranë Komisionit) mosmarrëveshja në këtë rast është me shtetin, që përfaqësohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Në përmbushje të detyrës së lënë nga Gjykata e Apelit Durrës dhe në bazë të kërkesës së paditësit, shtetasi F.Gj. është thirrur si person i tretë në gjykim, së bashku me trashëgimtarët e tjerë të të ndjerit I.Gj. dhe gjatë gjykimit ankuesi nuk ka paraqitur asnjë kërkesë procedurale për pozicionimin e tij sipas parashikimeve të nenit 189 e vijues të Kodit të Procedurës Civile si ndërhyrës kryesor apo dytësor”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues i Komisionit, pasi administroi provat e depozituara nga subjekti pas kalimit të barrës së provës dhe dëgjoi shpjegimet e subjektit në seancë dëgjimore, vëren se shtetasi G.Gj. ka filluar marrëdhënien e punës më punëdhënësin, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, në datën 1.12.2016, fillimisht si sekretar zëvendësues dhe më pas marrëdhënia e tij e punës ka vazhduar, duke u rinovuar me anë të kontratave individuale të punës me afat të caktuar deri në datën 6.12.2018, kohë kur ai ka kërkuar të zgjidhë marrëdhënien e punës.

Me urdhrin nr. ***, datë 6.12.2018, “Për zgjidhjen e kontratës së punës dhe rregullimin e efekteve financiare” Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka zgjidhur marrëdhënien e punës me z. G.Gj. në datën 17.12.2018.

Subjekti i rivlerësimit, në periudhën 9.1.2019 – 27.1.2022²¹, ka qenë i zgjedhur si zëvendëskryetar nga Mbledhja e Përgjithshme e gjyqtarëve të kësaj gjykate, periudhë e cila është më vonë se fillimi dhe mbarimi i marrëdhënies së punësimit të shtetasit G.Gj. me punëdhënësin Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Trupi gjykues, në përfundim të arsyetimit, konkludon se subjekti ka arritur të shpjegojë bindshëm se ai nuk ndodhet në situatën e konfliktit të interesit në gjykimin e çështjes civile, me palë paditëse shtetasin G.Gj.

9.2. Denoncim i shtetasve E. dhe A. Sh., regjistruar me nr. *** prot., datë 12.10.2018. Në denoncimin e tij këta shtetas denoncojnë subjektin së bashku me disa gjyqtarë të tjerë për gjykim të padrejtë, të njëanshëm. Formularit të denoncimit i ka bashkëlidhur aktekspertimin datë 26.7.2016 të grupit të ekspertëve ing. A.M. dhe ing. L.K. Çështja civile me palë paditëse G.H., etj. dhe të paditur ZVRPP-ja Durrës, A.Sh. E.Sh., objekt “anulimi pjesor i vendimit nr. ***, datë 22.6.1995, të KKKP-së Durrës”.

Detyrimi i të paditurve të njohin pronar paditësit në sipërfaqen ndërtimore prej 440 m². Detyrimi i ZVRPP-së Durrës të çregjistrojë nga regjistri nr. ***, datë 24.7.1995, sipërfaqen prej 640 m² truall, si dhe të regjistrojë pronën në emër të paditësve. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur: “Pranimin e kërkesëpadisë së paditësve G.H. etj., anulimin e pjesshëm të vendimit nr. ***, datë 22.6.1995, të KKKP pranë Bashkisë Durrës, për sipërfaqen e truallit prej 652 m², mbi të cilën janë ndërtuar kabinat nr. 1 dhe nr. 2., detyrimin e trashëgimtarëve të A.Sh. dhe E.Sh. të njohin pronarë paditësit G.H. etj., detyrimin e ZVRPP-së Durrës që të çregjistrojë nga regjistri nr. ***, datë 24.7.2005, sipërfaqen prej 625 m² dhe regjistrimin në favor të paditësve dhe personave të tretë A.L. etj.”.

Me vendimin nr. ***, datë 29.5.2008, të Gjykatës së Apelit Durrës, është vendosur: “Lënia në fuqi e vendimit nr. ***, datë 18.7.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës”. Dosja ndodhet në Gjykatën e Lartë, bazuar në rekursin e ushtruar nga shtetasit A. dhe E. Sh.

Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës të shpjegojë arsyet e kohëzgjatjes së kësaj çështjeje më shumë se dy vjet.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, ndër të tjera, deklaroi se *faktorët që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e shqyrtimit të çështjes janë:*

1. E ka marrë çështjen për gjykim 6 muaj nga momenti i regjistrimit të saj, pasi dy gjyqtarë të tjerë kanë dhënë dorëheqjen.

²¹ Vërtetim nr. *** prot., datë 16.11.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

2. Kjo çështje është gjykuar nga tre gjyqtarë, caktimi i seancave me tre gjyqtarë është më pak fleksibël se me një gjyqtar për shkak të ngarkesave individuale.

3. Kohëzgjatja e lejes vjetore 6 javë kalendrike. Në periudhën e gjykimit të kësaj çështjeje përfshihet leja vjetore e viteve 2005 dhe 2006, 45 ditë kalendrike për çdo vit.

4. Kërkesat për shtyrje të gjykimit nga vetë pala ankuese. Konstatohet se pjesa më e madhe e seancave gjyqësore janë shtyrë nga shtetasit A. dhe E. Sh. për shkaqe që lidhen me to (mungon avokati, kanë ndryshuar 4 herë avokatin gjatë gjykimit të çështjes, probleme me njoftimet e tyre si mosmarrja dijeni për seancën e gjykimit).

5. Periodiciteti i shpeshtë i seancave. Rezulton nga dosja se pavarësisht kohëzgjatjes së çështjes shtyrja e seancave është bërë në një kohë relativisht të shkurtër, janë zhvilluar gjithsej 38 seanca, çka tregon impenjim nga trupi gjykues për gjykimin e çështjes brenda afatit të arsyeshëm.

6. Procesi i të mbledhurit të provave. Në gjykim është marrë edhe prova me ekspert dhe për shkak të specifikës së çështjes është dashur një kohë e caktuar që të kryhet akti dhe të administrohet versioni përfundimtar nga gjykata.

7. Në rast të mosnjoftimit rregullisht për seancën vijuese, gjykata duhet të shtynte seancën për njoftimin sërish të palëve, për të cilat nuk kishte konfirmim zyrtar për marrjen dijeni.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

Komisioni, pasi administroi dosjen gjyqësore të çështjes që i përket vendimit nr. ***, datë 18.7.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, pas kryerjes së analizës, vëren se në procesverbalet e seancave gjyqësore gjejnë mbështetje pretendimet e subjektit në lidhje me kohëzgjatjen e çështjes.

Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm se arsyet e kohëzgjatjes së çështjes janë të lidhura me fakte dhe rrethana që nuk varen nga vullneti i tij për zgjidhjen e mosmarrëveshjes brenda afatit ligjor.

Sipas ligjit procedural civil subjekti duhet të respektojë procesin e rregullt ligjor, duke respektuar të drejtat e palëve si e drejta e mbrojtjes, njoftimi dhe marrja dijeni për seancat gjyqësore, njohja me aktet dhe dokumentacioni teknik etj., arsye këto që në rastin e çështjeve komplekse bëhen shkak për një kohëzgjatje të gjykimit tej afateve të arsyeshme.

Në lidhje me denoncimet e tjera, Komisioni, pasi i analizoi ato, vlerësoi se këto denoncime nuk përmbushin kriteret e pikës 2 të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

Konkluzioni i Komisionit lidhur me denoncimet

Trupi gjykues, pasi analizoi denoncimet e mësipërme sipas ligjit nr. 84/2016 dhe pasi analizoi shpjegimet e dhëna dhe dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, nuk konstatoi të dhëna, prova dhe fakte lidhur me veprime korruptive apo shkelje ligjore të subjektit të rivlerësimit dhe nuk gjeti elemente që përbëjnë dyshime për paaftësi profesionale apo që cenojnë figurën e gjyqtarit.

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores, arrin në përfundimin se:

- subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale;

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të neneve 51 dhe 58, germa “a” e pikës 1 dhe nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Markelian Koça, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë në datën 22.11.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Pamela QIRKO

Kryesuese

Xhensila PINE

Relatore

Suela ZHEGU

Anëtare

Sekretare gjyqësore

Jonida Vrana